RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PERIUDHA 01.01.2018 – 31.12.2018

"ATELIER 4" SHPK

04 PRILL 2018

BENDIS HUSI
AUDITUES LIGJOR

Bendis Husi

PËRMBAJTJA

I. RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

II. PASQYRAT FINANCIARE 31.12.2018

- PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)
- PASQYRA E PERFORMANCËS (PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE)
- PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE
- PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO

III. SHËNIME PËR DREJTIMIN E SHOQËRISË

- TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SHOQËRINË
- PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL
- ORGANIZIMI I KONTABILITETIT
- SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

I. RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
MBI AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË

"ATELIER 4" sh.p.k

DREJTUAR: "ASAMBLESË SË ORTAKËVE" SHOQËRISË "ATELIER 4" sh.p.k, Njësia administrative nr.5, Rruga e Kosovarëve, Ndërtesa 35, Hyrja 6, apartamenti 4/1, 1019, Tiranë.

Lidhur me shqyrtimin e Pasqyrave Financiare të periudhës janar-dhjetor 2018.

TË NDERUAR ZOTËRI!

OPINIONI

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë ***"ATELIER 4" shpk***, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë ***"ATELIER 4" shpk*** me datën 31 Dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

BAZA PËR OPINIONIN

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare.* Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Profesionistëve Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (kodi i BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

PËRGJEGJËSITË E DREJTIMIT NË LIDHJE ME PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Ne do të ushtrojmë gjykimin tonë profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit, në pajtim me SNA-të.

Ne do të identifikojmë dhe te vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, do të hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve si dhe, do të marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.

Ne do të sigurojmë njohjen dhe kuptimin për kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm të entitetit.

Ne do të vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve (vlerësimeve) kontabël dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.

Ne do të arrijmë në një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë nga ana e drejtimit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, do të vlersojmë nëse ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarje ose rrethana të cilat mund të hedhin një dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Konkluzionet tona do të bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri ne datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana të ardhshme mund të bëjnë që entiteti të ndalojë së vijuari veprimtarinë.

TIRANË, 04 PRILL 2018

AUDITUES LIGJOR

Bendis Husi

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2018

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	AKTIVET	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
I	**Aktive Afatshkurtra**		
1	**Mjetet Monetare**	92,982,063	105,994,057
2	**Investime**		
1)	Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit		
2)	Aksionet e veta		
3)	Te tjera financiare		
	Totali	**92,982,063**	**105,994,057**
3	**Te drejta te arketueshme**		
a)	Nga aktiviteti i shfrytezimit	86,258,357	70,424,846
b)	Nga njesite ekonomike brenda grupit		
c)	Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese	3,878,699	
d)	Te tjera	6,898,007	7,682,464
e)	Kapital i nenshkruar i papaguar		
	Totali	**97,035,063**	**78,107,310**
4	**Inventari**		
a)	Lende e pare dhe materiale te konsumueshme		
b)	Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte		
c)	Produkte te gatshme		
d)	Mallra	-	-
e)	Aktive biologjike (Gje e gjalle ne rritje e majmeri)		
f)	AAGJM te mbajtura per shitje		
g)	Te tjera		2,575,434
h)	Parapagime per inventar		
	Totali		2,575,434
5	Shpenzime te shtyra	18,291,765	11,135,949
6	Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara	-	-
	Total i Aktiveve Afatshkurtra	**208,308,891**	**197,812,750**
II	**Aktive Afatgjata**		
1	**Aktive financiare**		
a)	Tituj pronesie ne njesite ekonomike brenda grupit		
b)	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit		
c)	Tituj pronesie ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
ç)	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
d)	Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjata		
e)	Tituj te tjere te huadhenies		
	Totali	-	-
2	**Aktive Afatgjata Materiale**		
a)	Toka dhe ndertesa	47,585,645	47,585,645
b)	Impiante dhe makineri	3,868,769	5,466,096
c)	Te tjera instalime dhe pajisje	17,761,647	9,928,221
ç)	Parapgime per aktive materiale dhe ne proces	-	-
	Totali	**62,979,962**	**62,979,962**
3	**Aktive Biologjike Afatgjate**		
4	**Aktive Afatgjata Jomateriale**		
a)	Koncesione, licensa, marka tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme	56,000	56,000
b)	Emer i Mire		
c)	Parapagime per AAJM		
	Totali	**56,000**	**56,000**
5	**Aktive tatimore teshtyra**		
	Totali i Aktiveve Afatgjata	**68,750,123**	**63,035,962**
	TOTALI AKTIVEVE	**277,059,014**	**262,767,164**

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

ALBAN EFTHIMI
Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI
L52222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2018

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	PASIVET DHE KAPITALI	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
I	**Detyrimet afatshkurtra**		
1	**Huamarrjet**		
1)	Titujt e huammarrjes		
2)	Detyrimet ndaj institucioneve te kredise	-	-
3)	Arketime ne avance per porosi		
4)	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	61,032,447	25,732,746
5)	Deftesa te pagueshme		
6)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
8)	Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetesore	800,738	366,077
9)	Te pagueshme per detyrimet tatimore	7,905,998	7,760,709
10)	Te tjera	36,718,618	69,768,881
11)	Huadhenie afatshkurter		2,493,288
	Totali	**106,457,801**	**106,446,228**
4	**Te pagueshme per shpenzime te konstatuara**		32,021
5	**Te ardhura te shtyra**		
6	**Provizione**	5,536,118	5,536,118
	Pasive Totale Afatshkurtra	**111,993,919**	**112,014,367**
II	**Detyrime afatgjata**		
1	**Huate afatgjata**		
1)	Titujt e huamarrjes		
2)	Detyrime ndaj institucioneve te kredise	12,209,552	9,537,166
3)	Arketimet ne avance per porosi		
4)	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit		
5)	Deftesa te pagueshme		
6)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
8)	Te tjera te pagueshme		
	Totali	**12,209,552**	**9,537,166**
2	**Te pagueshme per shpenzime te konstatuara**		
3	**Te ardhrua te shtyra**		
4	**Provizione:**	-	-
1)	Provizione per pensionet		
2)	Provizione te tjera	-	-
4	**Detyrime tatimore te shtyra**		
	Pasive Totale Afatgjata	**12,209,552**	**9,537,166**
	Totali i pasiveve	**124,203,471**	**121,551,533**
III	**Kapitali**		
1)	**Kapitali i nenshkruar**	90,700,000	90,700,000
2)	**Primi i lidhur me kapitalin**		
3)	**Rezerva rivleresimi**		
4)	**Rezerva te tjera**		
a)	Rezerva ligjore	10,000	10,000
b)	Rezerva statutore		
c)	Rezerva te tjera	49,936	49,936
5)	**Fitimi i pashperndare**	48,537,248	29,724,853
6)	**Fitimi (humbje) e vitit financiar**	9,679,660	18,812,393
7)	**Fitim I vitit dega Kosove**	3,878,699	
	Totali i Kapitalit	**152,855,543**	**139,297,182**
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	**277,059,014**	**260,848,715**

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

ALBAN EFTHIMI
Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI
L52222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2018

Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

	PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
1	**Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit**	**248,350,320**	**195,650,045**
2	**Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces**	-	-
3	**Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar**		
4	**Te ardhura te tjera te shfrytezimit**	395,580	3,415,277
5	**Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme**	-	-
a)	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	-	-
b)	Te tjera shpenzime		
6	**Shpenzimet e personelit**	**40,246,771**	**33,107,666**
a)	Pagat dhe shperblimet	35,131,794	29,130,116
b)	Shpenzimet e sigurimeve shoqerore/shendetesore	5,114,977	3,977,550
c)	Shpenzime te tjera per personelin	-	-
7	**Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale**		
8	**Shpenzime konsumi dhe amortizimi**	7,456,950	6,432,237
9	**Shpenzime te tjera shfrytezimi**	180,503,469	134,189,998
		20,538,710	**25,335,421**
10	**Te ardhura te tjera**	**1,664,285**	**1,078,689**
a)	Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese(paraqitur vecmas te ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit	*1,664,285*	*1,078,689*
b)	Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera pjese e aktiveve afatgjata(paraqitur vecmas te ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)		
c)	Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme(paraqitur vecmas te ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)		
11	**Zhvleresimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra**		
12	**Shpenzime financiare**	**9,199,835**	**3,064,119**
a)	Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme(paraqitur vecmas shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)	**550,310**	**393,420**
b)	Shpenzime te tjera financiare	**8,649,525**	**2,670,699**
		(7,535,550)	**(1,985,430)**
13	**Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesemarrjet**		
14	**Fitimi/Humbja para tatimit**	**13,003,160**	**23,349,991**
15	**Shpenzimet e tatimit mbi fitimin**	**3,323,500**	**4,537,598**
a)	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	3,323,500	4,537,598
b)	Shpenzimi aktual i tatimit fitimit te shtyre		
c)	Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve		
16	**Fitim (humbje) neto e vitit**	**9,679,660**	**18,812,393**
17	**Fitim (humbje) per:**		
a)	Pronaret e njesise ekonomike meme		
b)	Interesa jo-kontrolluese		

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

ALBAN EFTHIMI
Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

ATELIER

BENDIS HUSI
L52222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2018

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare (Metoda Indirekte)

Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	**2018**	**2017**
Fitim / Humbja e vitit	16,881,859	23,349,991
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	(3,323,500)	(4,537,598)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7,456,950	6,432,237
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(26,083,569)	18,191,819
Rënie/(rritje) në inventarë	2,575,434	(2,575,434)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(130,579)	(30,592,534)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	110,134	324,527
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	**(2,513,271)**	**10,593,008**
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(5,714,161)	(11,998,784)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		
Dividentë të arkëtuar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	**(13,171,111)**	**(18,431,021)**
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		
Hua të arkëtuara		
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		
Riblerje e aksioneve të veta		
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
Pagesa e huave	2,672,386	9,537,166
Pagesë huadhënie		
Interes i paguar		
Dividendë të paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	**2,672,386**	**9,537,166**
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	**(13,011,996)**	**1,699,153**
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	105,994,059	104,294,906
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	**92,982,063**	**105,994,059**

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

ALBAN EFTHIMI
Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

ATELIER

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2018
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	**90,700,000**	-	-	**10,000**	-	-	**49,936**	**29,724,853**	**120,484,789**		**120,484,789**
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017	**90,700,000**	-	-	**10,000**	-	-	**49,936**	**29,724,853**	**120,484,789**	-	**120,484,789**
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Fitimi / Humbja e vitit								9,679,660	**9,679,660**		**9,679,660**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:									-		-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									-		-
Dividendë të paguar									-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike							**29,724,853**	**(29,724,853)**	-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	**90,700,000**	-	-	**10,000**	-	-	**29,774,789**	**18,812,393**	**139,297,182**	-	**139,297,182**
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2018	**90,700,000**	-	-	**10,000**	-	-	**48,587,182**	-	**139,297,182**	-	**139,297,182**
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Fitimi / Humbja e vitit								13,558,359	**13,558,359**		**13,558,359**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:									-		-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									-		-
Dividendë të paguar									-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	**90,700,000**	-	-	**10,000**	-	-	**48,587,182**	**13,558,359**	**152,855,542**	-	**152,855,542**

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

ALBAN EFTHIMI
Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

II. SHËNIME PËR DREJTIMIN E SHOQËRISË

Shoqëria "ATELIER 4" shpk, Njësia administrative nr.5, Rruga e Kosovarëve, Ndërtesa 35, Hyrja 6, apartamenti 4/1, 1019, Tiranë.

Periudha ushtrimore 01 Janar 2018 deri 31 Dhjetor 2018

❖ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Shoqëria "ATELIER 4" sh.p.k, është regjistruar si shoqëri me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Nr. 29131 datë 19.02.2003, me seli në Tiranë dhe adresë Njësia administrative nr.5, Rruga e Kosovarëve, Ndërtesa 35, Hyrja 6, apartamenti 4/1, 1019.
Krijimi i shoqërisë është bazuar në ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 dhe ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993, përkatësisht "Për Shoqëritë Tregtare" dhe "Për Regjistrin Tregtar". Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Ajo është e regjistruar në organet tatimore me NIPT K31812012H.
Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në fushën projektime dhe studime urbanistike: projektime e ndërtime civile, industriale turistike, bujqësore: studime ambjentale dhe vlerësim të ndikimit në Mjedis: projektime interieresh: Projektim Peisazhi e sistemimi: studime e projektime hidrogjeologjike dhe gjeologjike: projektime Rrugësh, Urash, Porte turistike: projektime të inxhinjerisë elektrike, të inxhinjerisë hidro-mekanike: projektime konstruktive dhe supervizion punimesh: restaurime. Si dhe konsulenca për temat e mësipërme.
Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të zhvillohet në një afat kohor të papërcaktuar.

✓ Kapitali dhe pronësia

Shoqëria "ATELIER 4" shpk, në krijimin e saj ka patur një kapital themeltar 100,000 lekë të ndarë në 100 pjesë me vlerë nominale 1,000 secila.
Shoqëria "ATELIER 4" shpk është një shoqëri e përbërë nga katër ortakë përkatësisht Z.Alban Efthimi i cili zotëron 60% të pjesëve të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë, Z.Andi Efthimi i cili zotëron 10% të pjesëve të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë, Z.Altin Premti i cili zotëron 20% të pjesëve të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë dhe Z.Olsi Efthimi i cili zotëron 10% të pjesëve

të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë. Me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë kapitali është rritur në 90,700,000 lekë, i ndarë në 4 pjesë. Ndryshimet e fundit në kapitalin e nënshkruar janë rregjistruar në QKB më datë 16.09.2016.

✓ **Administrimi**

Struktura organike, Administrimi, Organizimi, Drejtimi i përshtaten natyrës së shoqërisë dhe realizimit të objektit të veprimtarisë së saj. Shoqëria drejtohet nga Administratori i cili është Z.Alban Efthimi.

❖ **PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL.**

✓ **Mënyra e pregatitjes së Pasqyrave Financiare**

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në të gjithë aspektet e tyre materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin Nr.9477 datë 09.02.2006 për "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit" si dhe Urdhërin Nr.64 datë 22.07.2014 për "Shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre" të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave.
Pasqyrat Financiare janë përgatitir duke zbatuar Politikat Kryesore Kontabël:
Politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe vlerësimin e tyre.
Gjatë pregatitjes së Pasqyrave Financiare janë mbajtur parasysh Parimet Bazë të Kontabilitetit si: Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Parimi i njësisë ekonomike raportuese, Parimi i vijimësisë si dhe Parimi i kompensimit. Karakteristikat cilësore të përgatitjes së Pasqyrave Financiare të cilat e bëjnë informacionin të dobishëm për përdoruesit dhe që janë përdorur gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare janë: Kuptueshmëria, Rëndësia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formen ligjore, Paanshmëria, Plotësia, Maturia, Qëndrueshmëria dhe Krahasueshmëria.
Pasqyrat Financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e Kostos Historike.
Pasqyrat Financiare janë shrehur në monedhën vendase LEKË.

Deklarata e përpuethshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Përmirësuara të Kontabilitetit të cilat janë hartuar nga Këshilli Kombetar i Kontabilitetit të Rrepublikës së Shqipërisë dhe të shpallura nga Ministri i Financave.

Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në metodën e kostos historike.

Monedha funksionale dhe raportuese
Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lekë, e cila është monedha funksionale për shoqërinë.

Humbje nga rënia në vlerë e aktiveve

Shoqëria teston vlerën e aktiveve të saj financiare rregullisht për të konstatuar rënie të mundshme vlere. Për të përcaktuar nëse një rënie e mundshme vlere duhet njohur në pasqyrën e të ardhurave, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dallueshme që të ketë një rënie të matshme në flukset monetare të pritshme nga portofoli i aktiveve financiare, përpara se ulja të identifikohet e ekspozuar individualisht në portofol.
Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dallueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim jo të favorshëm në gjendjen e pagesave të klientëve në Shoqëri, apo në gjëndjen ekonomike kombëtare apo lokale që lidhet me mospagesat në aktivet e Shoqërisë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet financiare dhe detyrimet për të cilat nuk ka një çmim tregu të dallueshëm, kërkohet përdorimi i teknikave vlerësuese siç përshkruhet në shënimin 4 në pasqyrat financiare.

Përllogaritja e tatim fitimit

Drejtimi beson se përllogaritja e kujdesshme e tatimit mbi fitimin duke pasur parasysh ambientin fiskal shqiptar dhe legjislacionin ekzistues në fuqi si dhe rezultatet e mundshme të cdo inspektimi tatimor, nuk do të ketë ndikim sinjifikativ në pozicionin financiar, rezultatin operativ apo flukset monetare të Shoqërisë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK, kërkon që drejtimi i shoqerisë të kryejë gjykime, çrnuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasoje e këtyre çmuarjeve.
Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme.Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato

ndikohen. Në vecanti, informacion mbi elemente të rëndësishem në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në paragrafët më poshtë.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Mjeteve Monetare**

Mjetet Monetare përfaqsojnë likuiditetet e njësisë ekonomike në Arkë dhe në Bankë, në llogari rrjedhëse, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide duke ndjekur politikën e Vlerës së Drejtë në zbatim të SKK 3.

(a) Veprimet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i kembimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë, Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumentëve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka).

Kurset e këmbimit më të rëndësishme janë :

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2018
Euro	132.95	123.42
Usd	111.10	107.82

(b) Instrumenta financiare

Instrumentë financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhave të raportimit shoqëria nuk ka investime në letra me vlerë. Instrumentët financiarë jo-derivativë janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumentëve financiarë joderivativë përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet në rast se Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi

financial përfundojnë, ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, psh datën në të cilën Shoqëria zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anulluar.

(c) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka. Për qëllime të fluksit të mjeteve monetare, këtu përfshihen edhe depozitat në formën e garancisë për huatë me maturitet më shumë se 3 muaj ose më pak nga data origjinale.

✓ Rregullat për vlerësimin e Aktiveve të tjera financiare afatshkurtra

Aktive të tjera financiare afatshkurtra, kërkesa të arkëtueshme afatshkurtra, letra me vlerë dhe investime të tjera financiare janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara apo dokumentëve të tjerë kontabël. Politika kontabël e ndjekur për aktivet financiare afatshkurtra është sipas kostos së amortizuar (vlerë nominale të kërkesës për arkëtim minus zhvlerësim nëse ka) sipas SKK 3. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave dhe dokumentëve origjinalë kontabël. Llogaritë e aktiveve të tjera financiare afatshkurtra në monedhë të huaj, në datën e mbylljes së bilancit janë vlerësuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2018. Diferencat respektive janë të reflektuara në llogaritë e rezultatit.

✓ Rregullat për vlerësimin e Gjendjeve të Inventarit

Gjendjet e Inventarit të shoqërisë përbëhen nga Mallrat për rishitje të cilat vlerësohen me vlerën më të vogël të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshin materialet direkte dhe punën direkte kur është e aplikueshme dhe kostot e tjera që janë shpenzuar për të sjellë inventarët në gjendjen dhe vendin aktual. VIera neto e realizuar tregon vlerën e çmuar të çmimit të shitjes në aktivitetin e biznesit, duke i zbritur koston e çmuar të marketingut, shitjes dhe shpërndarjes. Kostoja e inventareve të tjerë është bazuar në parimin FIFO (e hyra e parë e dala e parë) dhe përfshin shpenzimet e përdorura në përvetësimin e inventarit dhe per ti sjellë ato në kushtet dhe vendin e tyre ekzistues. Shuma e përshtatshme për zhvlerësim njihet në pasqyrën e të ardhurave kur ka një evidencë objektive që aktivi është zhvlerësuar. Kosto e inventarit është llogaritur për çdo zë duke përdorur metodën FIFO në zbatim të SKK 4. Në të përfshihen shpenzimet e blerjes së mallrave, shpenzimet e transportit, shpenzimet në doganë, shpenzimet e ngarkim-shkarkimit si dhe çdo shpenzim tjetër i bërë deri në magazinimin e mallrave.

✓ Rregulla për vlerësimin e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra përfaqsojnë shpenzimet e bëra gjatë vitit financiar por që u përkasin periudhave të ardhshme të njësisë ekonomike. Për to është ndjekur politika kontabël kosto minus zhvlerësim nëse ka, pasqyruar sipas përcaktimit e në zbatim të SKK 1.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Aktiveve Afatgjata**

Aktivet afatgjata material dhe jomateriale pasqyrohen në bilanc me vlerën e tyre neto.

Aktivet Afatgjatë jomaterialë sipas SKK 5 janë përfshirë në Pasqyrat Financiare duke ndjekur politikën kontabël Kosto e blerjes ose prodhimit ose shumën e rivlerësuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka.

Aktivet Afatgjatë materialë sipas SKK 5 janë përfshirë në Pasqyrat Financiare duke ndjekur politikën kontabël Kosto e blerjes ose prodhimit ose shumën e rivlerësuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka. Metoda e llogaritjes së amortizimit bëhet në zbatim të ligjit Nr.8438 datë 28.12.2008 "Për Tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Baza e llogaritjes së amortizimit bëhet mbi Vlerën Neto Kontabël. Llogaritja e amortizimit për aktivet e hyra gjatë vitit është bërë duke filluar nga data 1 e muajit pasardhës.

1. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materialë paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi, (nëse ka).
E gjithë pasuria e paluajtshme, ndërtesat dhe makineritë paraqiten në kosto, historike (sic pershkruhet në paragrafin e mëposhtëm) minus amortizimin përkatës dhe zhvlerësimin, përveç për tokën, e cila pasqyrohet me koston historike minus zhvlerësimin. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijne kostot e materialeve, punës direkte, si dhe çdo kosto tjetër që lidhet me sjelljen e këtyre aktiveve në gjëndje pune dhe kostot për çmontimin dhe lëvizjen e tyre dhe përgatitjen e vendit në të cilin do të vendosen. Programet kompjuterike të blera që janë të nevojshme për vendosjen në funksion të këtyre aktiveve të cilat kapitalizohen si pjesë të këtyre makinerive. Aktivet të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit kanë qenë të kontabilizuar me vlerën e bazuar në vlerën e tyre neto në datën e daljes jashtë përdorimit. Kostot e pjesëve të ndërrimit për makineritë dhe pajisjet njihen me vleren e tyre kontabël nëse është e mundur që njësia ekonomike të përfitojë të ardhura ekonomike nga kjo pjesë dhe këto të ardhura mund të maten në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes dhe riparimeve të përditshme të pasurive të paluajtshme, makinerive dhe pajisjeve njihen në fitim e humbje kur ato ndodhin.

2. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare mbi vlerën e mbetur kontabël në mënyrë që, kosto e cdo aktivi deri në vlerën e mbetur, të shpërndahet përgjatë të gjithë jetës së tij të dobishme si me poshte:

Ndërtesat	5 %
Instalime teknike, makineri e pajisje	20%
Mjete transporti	20%
Mobilje dhe orendi	20%
Pajisje zyre dhe informatike	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) të aktiveve materiale afatgjatë janë rishikuar në datën e raportimit. Toka dhe Ndërtimet në Proçes, si dhe parapagimet furnitorëve nuk amortizohen.
Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen nga krahasimi i përfitimeve me vlerën e tyre kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

3. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do ti rrjedhin Shoqërisë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmeri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

4. Aktivet e marra me qera

Aktivet e marra me qira janë të klasifikuara si qira financiare kur terrnat e transferimit të risqeve dhe pronësisë kalojnë te qiramarresi, Të gjitha qeratë e tjera janë të klasifikuara si qera operative. Asetet që janë rregjistruar si qera financiare rregjistrohen si asete të Shoqërisë me vlerën e drejtë në datën e fillirnit të qerasë, ose me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë nëse kjo e fundit është më e vogël. Pagesat e qerasë regjistrohen si shpenzime financiare dhe zvogëlimit të detyrimit të qerasë që të arrijë një normë konstante të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimit.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huamarrjeve Afatshkurtra**

Në huamarrjet afatshkurtra përfshihen huatë (deri në 12 muaj) për financime afatshkurtra si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve të qerasë financiare që do të paguhen Brenda 12 muajve të ardhshëm të klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politikën kontabël të kostos së

amortizuar. Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të pakësuara për humbjet për zhvlerësime.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huave dhe Parapagimeve**

Huatë dhe parapagimet janë vlerësuar sipas faturave të blerjes dhe dokumentëve të tjerë origjinalë kontabël. Politika kontabël e ndjekur është në bazë të kostos së amortizuar në zbatim të SKK 3.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huamarrjeve Afatgjata**

Në huamarrjet afatgjata përfshihen huatë (mbi 12 muaj) për financime afatgjata si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve të qerasë financiare që do të paguhen pas 12 muajve të ardhshëm të klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politikën kontabël të kostos së amortizuar.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Kapitalit**

Kapitali i shoqërisë vlerësohet sipas vlerës kontabël të kapitalit aksionar të emetuar në krijim të saj, rezervave të krijuara në përputhje me statutin si dhe në përputhje me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare" ose ndonjë ligj tjetër të aplikueshëm, fitimeve të pashpërndara që përbëjnë fitimet e akumuluara në vite si dhe fitimi ose humbja e vitit financiar që përbëhet nga fitimi ose humbja , në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

✓ **Rregullat e vlerësimit të të Ardhurave**

Të ardhurat përfaqsojnë shitjet neto e rrjedhimisht të ardhurat e përfituara nga shitja e mallrave dhe produkteve, shërbimeve gjatë periudhës kontabël të vlerësuara sipas SKK 8. Ato regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe të lidhjes që kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, panvarësisht se arkëtimi i tyre ose i një pjese prej tyre do të ndodhë në vitin ushtrimor pasardhës. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për tu arkëtuar dhe përfaqson vlerën e arkëtueshme përtë mirat dhe shërbimet e siguruara gjatë aktivitetit normal të shoqërisë, neto nga zbritjet dhe shitjet të lidhura me taksën. Shitjet e mallrave njihen kur mallrat janë dërguar dhe gjithashtu kanë kaluar dhe pronësinë e tyre. E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në pasqyrën e të ardhurave në përpjestim me volumin e shërbimit të kryer në datën e bilancit. Vlerësimi i volumit të shërbimit bëhet duke iu referuar survejimeve të punës së kryer.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Shpenzimeve Direkte**

Shpenzimet e njësisë ekonomike të vitit financiar përfaqsojnë shpenzimet e blerjes së mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara për veprimtarinë parësore, koston e shërbimeve kryesore të vlerësuara me çmimin e blerjes e të vërtetuara me fatura origjinale e dokumentë të tjerë kontabël, shpenzime që lidhen në mënyrë direkte me mallrat ose produktet e destinuara për shitje. Pagat, shpërblimet dhe kompensimet monetare, sigurimet shoqërore të paguara nga shoqëria të llogaritura mbi pagat që i përkasin periudhës kontabël panvarësisht nëse ato janë paguar ose jo. Shpenzimet për amortizimin që vijnë nga rënia në vlerë e aktiveve afatgjata. Shpenzimet e tjera që janë shpenzimet e papërfshira në zërat e mësipërm por që lidhen me veprimtarinë kryesore të njësisë ekonomike.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Shpenzimeve të Qerasë**

Pagesat e bëra për qeratë operacionale njihen në fitim ose humbje me mënyrën lineare gjatë periudhes së qirasë. Stimujt e qirasë së marrë njihen si një pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë periudhës së qirasë. Minimumi i pagesave të qerasë të bëra nën qeratë financiare janë shpërndarë midis shpenzimeve fiananciare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar është shpërndarë në çdo periudhë të termave të qerasë për të krijuar një normë interesi konstante periodike mbi tepricën e mbetur të detyrimit.

✓ **Rregullat e vlerësimit të shpenzimeve (të ardhurave) Financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huave njihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Tatimit mbi Fitimin**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në keto raste tatim fitimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshërn për vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet në normën e tatimit që pritet të aplikohet në diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin tatimor që janë ose hyjnë në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur

që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktivi tatimor i shtyrë zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Fondit të Pensioneve**

Shoqëria paguan kontribute për pensione si dhe contribute për sigurim shëndetsor për punonjësit e saj siç është parashikuar nga legjislacioni vendas. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtarë përgjegjës për pagesën e pensioneve dhe shërbimeve shëndetsore.

Sigurime shoqërore të detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhen normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Leje vjetore të paguara

Shoqëria njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhen në këmbim për shërbimin e punonjësve për gjatë periudhës.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Provizioneve**

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhjë e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të rregulluar detyrimin dhe një vlerësim të besueshëm të vlerës së detyrimit që mund të bëhet. Nëse efekti është material, provizionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë, dhe kur është e nevojshme riskun specifik të detyrimit. Provizionet paraqiten në cdo datë bilanci dhe nëse nuk është akoma e mundur që rrjedhja e burimeve duke personifikuar burime ekonomike të përdoret për rregullimet e detyrimeve, provizionet anullohen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje shfrytëzuese të ardhme. Aktivet dhe detyrimet e rastit nuk njihen.

✓ **Rregullat e Menaxhimit të Riskut Financiar**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiare:

- Risku i kredisë
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Menaxhimi mbart përgjegjësinë për vendosjen dhe mbikqyrjen e politikave të shoqërisë për menaxhimin e riskut. Këto politika duhet të rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e shoqërisë. Instrumentat financiare kryesorë të shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në bankë, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme si dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

Risku i kredisë

Në varësi të volumit të llogarive të arkëtueshme përcaktohet dhe risku i kredisë. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme mbahet në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar riskun potencial në mbledhjen e tepricave të llogarive të arkëtueshme.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj lidhur me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është i qënësishëm në shoqëri dhe menaxhohet duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet për flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Risku i tregut

Përbëhet nga risku i normave të interest dhe risku i kursit të këmbimit.

Risku i normave të interesit

Shoqëria përballet me riskun e normës së interest të flukseve të parasë në lidhje me hua dhe overdraft që ajo merr me normë variabël.

Risku i kursit të këmbimit

Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme në monedhë të huaj apo huatë janë faktorë që e ekspozojnë shoqërinë ndaj riskut të kursit të këmbimit.

Analiza e ndjeshmërisë

Duke administruar riskun e normave të interest dhe të pozicionit valuator, shoqëria mund të reduktojë ndikimet e luatjeve afatshkurtra në fitimet e saj. Në periudha afatgjata sidoqoftë menaxhimi i këtyre risqeve mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në fitim.

Administrimi i Kapitalit

Politikat e shoqërisë janë të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëvë dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit.

Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive zhvleresimi tregon se një ose, më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivit financiar.
Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshrne të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar.
Hurnbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të vlefshëm për shitje është llogaritur kundrejt vlerës së tij të drejtë. Aktivet financiare të cilat janë të konsiderueshme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet së bashku në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme risku. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Ndonjë humbje kumulative në lidhje me aktivet financiare të vlefshme për shitje të njohura me parë në letra me vlerë transferohet tek humbje fitimi. Një humbje nga zhvlerësimi mund të anullohet nëse ulja në zhvleësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Aktivet jo-financiare

VIera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi në periudhat e mëparshme janë rishikuar në çdo datë raportimi për rastet kur humbja rritet ose nuk ekziston më. Një humbje zhvlerësimi anullohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për caktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anullohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do te përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Kontabiliteti mbrojtës dhe instrumentat derivativë financiarë

Shoqëria nuk përdor instrumenta financiare mbrojtëse, panvarësisht se është e ekspozuar ndaj riskut financiar.

❖ ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin Nr.9477 datë 09.02.2006 dhe me SKK 2, Shoqëria ka ndërtuar një plan vetjak të llogarive në përputhje dhe në zbatim të SKK të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Departamenti i Financës përbëhet nga disa specialist finance. Kontabiliteti mbahet në mënyrë të informatizuar nëpërmjet programit të Kontabilitetit "Programi Alpha Platinium".

❖ SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Bendis Husi